

# Raporti monitorues i keqinformimit për muajin janar

## 2024

shkurt 2024

Action for  
Democratic Society  
[hibrid.info](http://hibrid.info)



# Raporti monitorues i keqinformimit për muajin janar

**Publikues:** ADS/hibrid.info

Prishtinë, shkurt 2024

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



# Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

Kontrulli dhe vlerësimi i deklaratave

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07. 08.

# Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkrues, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit janar 2024, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është i pari dhe i vetmi i llojit. Është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i nëntëmbëdhjetë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma hibrid.info e specializuar në kontroll të fakteve, edukim digjital dhe medial, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në këtë raport monitorues jepet një pasqyrë për formën e përmbajtjeve me karakter informues për dhe rreth ngjarjeve në Kosovë. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të japë një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues;
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese;
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues;
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese;
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues;
- Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave.

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info, e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti, është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

# Kategoritë vlerësuese të çrregullimit informativ

## KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese




Në bazë të monitorimit të 65 përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara gjatë muajit janar 2024, dezinformatat kanë dominuar për sa i përket trendeve të përmbajtjeve keqinformuese të publikuara nga media dhe publikues të ndryshëm.

Përderisa gjatë muajit dhjetor të vitit të kaluar (2023), kishin mbizotëruar lajmet e rreme si rezultat i publikimit të tyre në median sociale TikTok lidhur me armatosjen e FSK-së, në muajin janar 2024, dezinformata si kategori radhitet e para. Dezinformata rreth temave të ndryshme sociale, duke përfshirë këtu edhe ato për largimin masiv të popullsisë pas liberalizimit të vizave, kanë bërë që kjo kategori të radhitet e para me 26%.

Dezinformata pasohet nga artikujt “clickbait”, si mënyra më e shpeshtë e keqinformimit nga portalet informative (mediat). Artikujt clickbait kanë pothuajse përqindje të njëjtë krahasuar me muajin dhjetor të vitit të kaluar (2023), edhe pse në këtë muaj radhitet si e dyta për dallim nga muaji i kaluar kur radhitej si e treta.

Ndërsa, në vendin e tretë zë vend lajmi i rremë me 12% si rezultat i reduktimit të përmbajtjeve të rreme për armatosjen e FSK-së, të publikuara në median sociale TikTok, të cilat ndikuan që kjo kategori e vlerësimit të radhitej e para në muajin dhjetor të vitit të kaluar.



26% e artikujve keqinformues të trajtuar kanë marrë vlerësimin “dezinformatë”.

# Analizë e llojeve të vlerësimeve

# 1.1

## 01. Dezinformatë

Një pjesë e konsiderueshme e dezinformatave janë publikuar nga fusha sociale dhe ajo e sigurisë. Këto dezinformata u publikuan në media sociale (14%), media reale (9%) dhe portale të dyshimta (3%). Përmbajtjet të cilat u vlerësuan si dezinformata e që u publikuan në media reale, portale të dyshimta dhe media sociale në gjuhën shqipe, preknin kryesisht tema të ndryshme sociale, politike dhe të sigurisë, përfshirë këtu, pretendimet për punë në Zvicër, ndalimin e dinarit, armatosjen e FSK-së dhe të tjera. Ndërsa, përmbajtje që u publikuan në media reale në gjuhën serbe preknin temën e largimit masiv të popullsisë nga Kosova pas liberalizimit të vizave duke dezinformuar se një numër i madh i popullsisë është larguar dhe se ka filluar eksodi në Kosovë.

## 03. Lajm i rremë

Këto përmbajtje të rreme janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale dhe portale të dyshimta në gjuhën shqipe nga fusha e sigurisë dhe ajo e sociale. Pretendime të rreme u publikuan për ndarjen e mjeteve financiare nga ana e Qeverisë, pretendime të rreme ndërlidhur me punësim në Zvicër, për takim ndërmjet kryeministrit Kurti dhe presidentit të Turqisë, Erdogan, si dhe për luftë në Kosovë.

## 02. Clickbait

Të gjitha përmbajtjet e vlerësuara si “clickbait” janë publikuar nga publikues (media reale, portale të dyshimta dhe media sociale) në gjuhën shqipe. Një pjesë e konsiderueshme e tyre janë publikuar nga fusha sociale dhe ajo e kronikës së zezë. Përmbajtjet nga kronika e zezë preknin tema tragjike, përfshirë vdekje dhe vrasje të ndryshme, por që nuk kishin ndodhur në Kosovë dhe kjo nuk bëhet e ditur në titujt e artikujve. Ndërsa ato nga fusha sociale kishin të bënin me temën e largimit masiv të popullsisë pas liberalizimit të vizave, për çmimet e peletit dhe drurit, për ndarje të mjeteve financiare nga Qeveria dhe për shtrenjtimin e qirave të banesave.

## 04. Përmbajtje e paverifikuara

Pothuajse të gjitha përmbajtjet e paverifikuara janë publikuar në mediat sociale nga publikues në gjuhën shqipe dhe serbe. Kryesisht kanë mbizotëruar përmbajtje nga fusha sociale dhe ajo e sigurisë, por nuk kanë munguar përmbajtje nga fusha e politikës dhe sportit. Në kuadër të këtyre përmbajtjeve, janë publikuar imazhe të paverifikuara me pretendimin se paraqesin gjendjen nga konflikti Izrael-Hamas, armatosjen e FSK-së, fotografi të Papës të gjeneruara me inteligjencë artificiale etj.

## 05. Teori konspirative

Përmbajtjet e trajtuara dhe të vlerësuara si teori konspirative janë publikuar kryesisht nga fusha sociale. Këto përmbajtje u publikuan në gjuhën shqipe dhe serbe në media reale dhe llogari dhe faqe në mediat sociale. Përderisa përmbajtjet në gjuhën serbe janë publikuar në media reale përfshirë pretendimet e pa baza të Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, e cila plaçkitjet apo incidentet e ndryshme në vendbanimet me shumicë serbe i interpreton si tendencë me qëllim të dëbimit të serbëve nga vendbanimet e tyre në Kosovë. Ndërsa në gjuhën shqipe u publikuan teori konspirative ndërlidhur me pretendimin e rremë se në një tunel të një sinagoge në New York janë kryer vepra si rrëmbimi i fëmijëve dhe rituale satanike, dhe pretendime të pabaza për luftë në Kosovë dhe Bosnje gjatë muajit shkurt.

## 06. Mashtrim

Të gjitha përmbajtjet mashtruese janë publikuar në media sociale nga llogari dhe faqe në gjuhën shqipe. Në kuadër të këtyre përmbajtjeve u publikuan imazhe të montuara të hoxhës, Shefqet Krasniqi nga fusha sociale dhe fotografia e një ushtari suedez me pretendimin se është i FSK-së nga fusha e sigurisë. Po ashtu u publikuan përmbajtje mashtruese me pretendime për dhënie kredish dhe vlerësime nga klientët, si dhe për mundësinë për përmirësimin e llogarisë së biznesit të përdoruesit.

---

Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë: Gabim, Clickbait/Dezinformatë, Manipulim i fakteve/Dezinformatë, Clickbait/Manipulim i fakteve dhe Përmbajtje e paverifikuar/Gabim.




# Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

2

## KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave




Tema kryesore që ka mbizotëruar në përmbajtjet e trajtuara gjatë muajit janar 2024 janë rastet e ndryshme tragjike (vdekje, vrasje). Reduktimi i përmbajtjeve lidhur me konfliktin Izrael-Hamas dhe armatosjen e FSK-së të cilat dominuan në dy muajt paraprak (nëntor, dhjetor 2023) ka bërë që përmbajtje të ndryshme me tematikë “raste tragjike” përfshirë vdekje e vrasje të ndryshme të rikthehen në krye të temave keqinformuese.

Gjatë muajit janar, janë publikuar përmbajtje keqinformuese nga mediat serbe ndërlidhur me disa incidente në vendbanimet me shumicë serbe. Këto incidente u keqinterpretuan nga Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë si tendencë për dëbimin e serbëve nga vendbanimet edhe pse nuk u ofruan fakte për këtë, si dhe nuk dihej qëllimi dhe kryesit e veprës. Kjo ka bërë që kjo temë të radhitet si e dyta gjatë këtij muaji.

Që nga 1 janari qytetarëve të Republikës së Kosovës iu mundësua të lëvizin pa viza drejt vendeve të zonës Schengen, e që filluan të publikohen keqinformata ndërlidhur me largimin masiv të popullsisë. U publikuan në media reale dhe ato sociale përmbajtje clickbait dhe dezinformata rreth numrit të atyre që kanë udhëtuar nga Kosova duke mos dhënë informacione në titull apo edhe në përmbajtje se për çka po bëhet fjalë konkretisht. Si rezultat i këtyre përmbajtjeve keqinformuese kjo temë u radhit si e treta gjatë muajit janar.

Krahas këtyre temave, gjatë janarit ka pasur keqinformim lidhur me tema si: punë në Zvicër, manovra ushtarake në kufirin Kosovë-Serbi, konflikti Izrael-Hamas, armatosja e FSK-së, etj.



45% e temave kryesore janë për raste të ndryshme tragjike, incidente në vendbanimet serbe, largimin masiv të popullsisë, punë në Zvicër, manovra ushtarake Kosovë-Serbi, dhe konfliktin Izrael-Hamas.

# Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

## 2.1

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga media dhe publikues të ndryshëm, sipas matjeve të platformës hybrid.info, përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

### 01. Raste tragjike (vdekje, vrasje)

Të gjitha keqinformatat nga kjo temë janë publikuar në portale informative (12%) dhe media sociale (3%) nga fusha e kronikës së zezë. Një numër i konsiderueshëm i tyre është vlerësuar si “clickbait”, por nuk mungojnë edhe vlerësimet clickbait/manipulim i fakteve, dezinformatë dhe përmbajtje e paverifikuar/gabim. Artikujt në kuadër të kësaj teme të keqinformimit kanë trajtuar raste tragjike si vdekje, vrasje, aksidente dhe fatkeqësi në rrethana të ndryshme dhe për të cilat nuk bëhet e ditur në titujt e tyre vendi i ngjarjes me synim për të nxitur klikime nga lexuesit.

### 03. Largimi masiv i popullsisë

Pothuajse të gjitha përmbajtjet keqinformuese lidhur me këtë temë sociale janë publikuar në media reale dhe faqe në mediat sociale në gjuhën shqipe dhe media reale në gjuhën serbe. Përderisa përmbajtjet në gjuhën shqipe u vlerësuan si “clickbait” ato në gjuhën serbe u vlerësuan si dezinformatë. Keqinformatat në gjuhën shqipe kryesisht kishin të bënin me shifra të udhëtarëve nga aeroporti, ku titujt apo fotografitë e përdorura ishin çorientuese. Ndërsa në gjuhën serbe u publikuan dezinformata se ka nisur largimi masiv i popullatës nga Kosova, dhe se 10 mijë punëtorë nga sektori i gastronomisë janë larguar nga Kosova.

### 02. Vendbanimet serbe

Përmbajtjet keqinformuese ndërlidhur me incidentet në vendbanimet serbe janë vlerësuar si teori konspirative dhe janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe bazuar në komunikatat e Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë. Të gjitha këto përmbajtje ishin nga fusha sociale, ku plaçkitje apo incidente në vendbanimet serbe, Zyra i interpreton pa fakte se veprimi është bërë me qëllim të dëbimit të serbëve, edhe pse nuk dihen kryesit e veprës dhe qëllim i tyre.

### 04. Punë në Zvicër


Përmbajtjet keqinformuese lidhur me temën e punës në Zvicër janë publikuar nga faqe dhe llogari në mediat sociale në gjuhën shqipe. Këto keqinformata nga fusha sociale janë vlerësuar si dezinformatë, lajm i rremë dhe clickbait. Dezinformatë u vlerësua një lajm i vjetër për tregun zviceran të punës i publikuar të paraqitet si aktual. Lajm i rremë u vlerësua pretendimi i rremë se Zvicra po kërkon 1 milionë punëtorë. Ndërsa, clickbait u vlerësua lajmi i vjetër për mungesën e fuqisë punëtore në Zvicër, i ri-publikuar.

## Llojet e fushave

Rezultatet e monitorimit të çrregullimit informativ për muajin janar 2024 tregojnë se publikues të ndryshëm (media reale, portale të dyshimta dhe mediat sociale) kanë publikuar më së shumti keqinformata nga fusha sociale. Si rezultat i trajtimit të përmbajtjeve keqinformuese gjatë këtij muaji, shumë tema të ndryshme që ndërlidhen me aspektin social u përdorën për të keqinformuar. Pas atyre të sociale, përmbajtjet keqinformuese nga fusha e sigurisë janë përdor më së shumti për të keqinformuar.

### FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Këto dy fusha kanë dominuar edhe gjatë muajit të kaluar (dhjetor 2023), e që fusha sociale qëndron në përqindje të njëjtë (42% në dhjetor 2023, 43% në janar 2024), ajo e sigurisë ka pësuar rënie në përqindje si rezultat i reduktimit të zhvillimeve nga kjo fushë (31% në dhjetor 2023, 22% në janar 2024). Një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve keqinformuese kanë qenë nga fusha sociale përfshirë këtu edhe dy temat kryesore të këtij muaji: largimi masiv i popullsisë dhe incidentet në vendbanimet serbe. Socialja pasohet nga fusha e sigurisë si rezultat i publikimit të keqinformatave, manovra ushtarake në kufirin Kosovë-Serbi, armatosja e FSK-së dhe përmbajtjet të tjera lidhur me pagat e tyre apo imazhe të publikuara ku pretendohet se paraqesin pjesëtarë të FSK-së. Këto të dy fusha përbëjnë 65% të përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara gjatë muajit janar 2024.

Këto të dy fusha pasohen nga kronika e zezë si rezultat i artikujve clickbait të publikuara nga kjo fushë, e që radhiten në përqindjen më të lartë si kategori vlerësuese gjatë këtij muaji. Kronika e zezë pasohet nga politika me 9%.

Shumica e përmbajtjeve nga fusha sociale janë publikuar në media sociale (25%) dhe media reale (14%). Ato janë vlerësuar si dezinformatë me 11%, clickbait me 9%, teori konspirative me 8%, përmbajtje e paverifikuar me 5% dhe të tjera. Përdorësit 34% e përmbajtjeve nga kjo fushë janë në gjuhën shqipe, 9% janë në gjuhën serbe, që ndërlidhen më zhvillimet në Kosovë.

Pothuajse të gjitha përmbajtjet nga fusha e sigurisë janë publikuar në gjuhën shqipe duke mbizotëruar ato në media sociale (14%) dhe media reale (6%). Përmbajtjet keqinformuese nga fusha e sigurisë kryesisht u vlerësuan dezinformatë (6%), lajm i rremë (6%) dhe përmbajtje e paverifikuar (3%). Temat të cilat u përdorën për të keqinformuar nga kjo fushë janë: armatosja e FSK-së, stërvitjet dhe manovrat ushtarake në kufirin Kosovë-Serbi, paralajmërimet për luftë në Kosovë dhe Bosnje etj.

Një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve të kronikës e zezë janë publikuar në media reale dhe media sociale. Shumica prej tyre janë vlerësuar “clickbait” lidhur me raste tragjike si vdekje dhe vrasje në rrethana të ndryshme.

Keqinformatat nga fusha e politikës janë publikuar në media reale (5%) dhe media sociale (5%), ku pjesa e konsiderueshme janë vlerësuar si manipulim i fakteve/dezinformatë (3%) dhe dezinformatë (3%). Ndalimi i dinarit dhe i mallrave serbe, bashkimi Kosovë-Shqipëri, konflikti Izrael-Hamas, ishin disa nga temat që u përdorën për keqinformim nga fusha e politikës.



91% e përmbajtjeve keqinformuese të trajtuara janë për socialen, sigurinë, kronikën e zezë dhe politikën.

# Llojet e publikuesve


# 4

Bazuar në gjetjet e përmbajtjeve keqinformuese gjatë muajit janar 2024, të cilat janë trajtuar në bazë të metodologjisë, rezulton që numri më i madh i keqinformatave janë publikuar nga mediat sociale (52%). Krahasuar me muajin dhjetor 2023, mediat sociale kanë pësuar rënie prej 12% (nga 64% në dhjetor 2023, në 52% në muajin janar 2024). Kjo si rezultat i publikimit nga faqe dhe llogari në mediat sociale të një pjese të konsiderueshme të dezinformatave, të gjitha përmbajtjet të paverifikuara dhe lajmet e rreme.

Ndërsa përmbajtjet keqinformuese të trajtuara në mediat reale kanë shënuar rritje prej 15% (nga 25% në dhjetor 2023, në 40% në muajin janar 2024), si rezultat i publikimit në media reale të pothuajse të të gjithë artikujve clickbait, një pjese të konsiderueshme të dezinformatave dhe teorive konspirative.

Në portalet e dyshimta, ngjashëm si në muajin dhjetor, janë publikuar dhe trajtuar pothuajse numër i njëjtë i përmbajtjeve keqinformuese (nga 11% në dhjetor 2023, në 8% në muajin janar 2023). Një pjesë e keqinformatave të vlerësuara si “clickbait” dhe dezinformatë janë publikuar nga portalet e dyshimta.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES  
TË PUBLIKUESVE ME  
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




92% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar nga publikuesit në media sociale (52%) dhe në mediat reale (40%).

## Klasifikimi i publikimeve në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues të monitoruar gjatë periudhës një mujore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhë të tjera në lidhje me raportimet e tyre për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë.

### PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Mostra e monitorimit nga platforma “hibrid.info” fokusohet në përmbajtjet keqinformuese në gjuhën shqipe të publikuara në media, portale të dyshimta dhe faqe dhe llogari në mediat sociale, atëherë publikimet në këtë gjuhë mbizotërojnë në trajtim me 88%. Ndërsa në gjuhën serbe monitorohen kryesisht vetëm raportimet keqinformuese në mediat reale lidhur me zhvillimet për dhe rreth Kosovës dhe trajtohen pikërisht ato përmbajtje. Si rezultat i publikimit të dezinformatave për largim masiv të popullsisë nga Kosova për shkak të liberalizimit të vizave dhe teoritë konspirative lidhur me incidentet në vendbanimet serbe, keqinformatat në këtë gjuhë përbëjnë 12% të gjetjeve të trajtimeve të realizuara gjatë muajit janar 2024.

# Analiza e artikujve të kësaj kategorie

## 5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët e tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

### 01. Publikimet në gjuhën shqipe

0.1.Pak më shumë se gjysma e keqinformatave të trajtuara në gjuhën shqipe janë publikuar në media sociale (51%), ndërsa pjesa tjetër në media reale (29%) dhe portale të dyshimta (8%). Përderisa në muajin dhjetor 2023 kishin mbizotëruar lajmet e rreme, në janar 2024 dezinformatat dhe artikujt clickbait radhiten në krye, për shkak se pjesa dërrmuese e përmbajtjeve nga fusha e sociales dhe kronikës së zezë janë vlerësuar më këto dy kategori.

### 02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe (për dhe rreth Kosovës)

Të gjitha përmbajtjet keqinformuese të trajtuara në gjuhën serbe janë publikuar nga mediat reale që kanë trajtuar tema të sociales, sigurisë dhe politikës. Publikimet e mediave në gjuhën serbe janë vlerësuar si teori konspirative (6%), dezinformatë (3%), përmbajtje e paverifikuar (2%) dhe manipulim i fakteve/dezinformatë (2%). Përderisa teoritë konspirative kishin të bënin me incidentet në vendbanimet me shumicë serbe, dezinformatat ndërlidheshin me pretendimin për largimin masiv të popullsisë nga Kosova pas liberalizimit të vizave. Përmbajtje e paverifikuar për gjuajtje me armë në kufirin Kosovë-Serbi dhe manipulim i fakteve/dezinformatë për masakrën e Reçakut.

## Llojet e mediave sociale


Në këtë seksion analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar dhe shpërndarë nga publikuesit në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat tjera (mediat reale dhe portalet e dyshimta).

Nga përmbajtjet e gjetura dhe trajtuara në muajin janar 2024 del që 65% e tyre janë publikuar në Facebook, pasuar nga ato të publikuar në Tiktok me 31% dhe Telegram 3%.

Ashtu si në muajin paraprak (dhjetor 2023) edhe gjatë këtij muaji (janar 2024) mbizotërojnë keqinformatat e publikuara në Facebook duke shënuar rritje prej 11% (nga 55% sa ishte në dhjetor 2023 në 66% në janar 2024). Edhe keqinformatat në TikTok kanë pësuar rënie gjatë muajit janar 2024 prej 14% krahasuar me muajin dhjetor 2023 (nga 45% sa ishte në dhjetor 2023, në 31% në janar 2024).

Këto dy platforma pasohen nga media sociale Telegram (3%), në të cilën u publikua një përmbajtje e paverifikuar nga fusha e sigurisë.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË  
MEDIAT SOCIALE






# Llojet e publikuesve në mediat sociale

## 6.1

Kjo matje, përmes të dhënave monitoruese, analizon ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, llogarive, mediave dhe kanaleve që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Përmbajtjet e gjetura dhe trajtuara në mediat sociale për muajin janar 2024 më së shumti u publikuan në faqe të ndryshme në Facebook (51%), pasuar nga llogari në TikTok (31%). Krahas kësaj, 11% e përmbajtjeve u publikuan nga faqe të mediave në Facebook dhe 3% nga llogari në Facebook dhe Telegram.

### PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



# Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

## 01. Facebook

Përmbajtje e paverifikuar (14%), clickbait (14%) dhe dezinformatë (14%) janë kategoritë me të cilat më së shumti janë vlerësuar keqinformatat e publikuara nga faqe, llogari në Facebook. Shumica e këtyre përmbajtjeve keqinformuese janë nga fusha e sociale (37%), pasuar nga kronika e zezë (9%) dhe ajo e sigurisë (6%). Në shumësinë e temave të cilat janë përdor për të keqinformuar në Facebook, mbizotërojnë konflikti Izrael-Hamas (9%), punësim në Zvicër (6%) dhe raste të ndryshme tragjike (6%).


## 02. TikTok

Shumica e përmbajtjeve keqinformuese të publikuara në TikTok janë kategorizuar si lajm i rremë (14%) dhe dezinformatë (11%). Një pjesë e konsiderueshme e përmbajtjeve keqinformuese janë nga fusha e sigurisë (17%), pasuar nga ajo e sociale (9%). Sa i përket temave, lajme të rreme për stërvitje ushtarake në kufirin Kosovë-Serbi, takimin Kurti-Erdogan dhe për punë në Zvicër. Dezinformata për mbylljen e Prishtina Mall, për manovra ushtarake në kufirin Kosovë-Serbi dhe pretendime për bashkimin Kosovë-Shqipëri.

# Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.

## RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES




Në bazë të monitorimit për muajin janar 2024, në përmbajtjet keqinformuese të publikuara për dhe rreth zhvillimeve në Kosovë, Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë është institucioni më i përfolur. Ky institucion u përfol nga mediat në gjuhën serbe në katër përmbajtje keqinformuese, përfshirë këtu interpretimin e incidenteve në vendbanimet serbe si tendencë për dëbimin e tyre nga Kosova koordinuar nga Prishtina zyrtare.

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), si institucion i sigurisë, është institucioni i dytë më i përfolur në përmbajtjet keqinformuese. Ky institucion i sigurisë u përfol në tre përmbajtjet keqinformuese lidhur me armatosjen e këtij institucioni me armë të ndryshme, si dhe pretendime rreth pagave të tyre.

Ndërsa, Policia e Kosovës u përfol në një lajm të rremë ku pamjet e stërvitjeve ushtarake të forcave të Azerbajxhanit, paraqiten si momente të ushtrimeve të Njësisë Speciale të Policisë së Kosovës.

---

## RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



---

Ministri i mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Ejud Maqedonci është figura më e përfolur në keqinformatat e gjetura dhe trajtuara gjatë muaji janar 2024. Ministri Maqedonci u përfol në publikimin në mediat sociale me pretendimin dezinformues se FSK do të pajiset me anti-tank “Panzerfaust”, si dhe në raportimin gabim të mediave lidhur me investimet për armatim brenda një mandati.

Benjamin Netanjahu, Shefqet Krasniqi dhe Papa Françesku janë tre figurat tjera që janë përfolur nga një herë.

U publikua Kopertina e revistës “Time” me imazhin e rremë të Benjamin Netanyahut. Në mediat sociale u publikua një fotografi e montuar e Shefqet Krasniqit me uniformë ushtarake serbe. Po ashtu, është publikuar edhe imazh i gjeneruar me inteligjencë artificiale i Papa Françeskut ku shihet në momente intime me një grua.



# Kontrolli dhe vlerësimi i deklaratave

Hibrid.info, përveç kontrollit dhe analizës së artikujve mediatik, bën edhe kontrollin dhe vlerësimin e deklaratave të zyrtarëve të lartë politikë e institucionalë, si dhe figurave që kanë ndikim publik. Vlerësimi i këtyre figurave, sipas metodologjisë së hibrid.info, bëhet në kategoritë e vërtetësisë, qëndrueshmërisë dhe përmbajtjes së premtimeve.

## RENDITJA E KONTROLLIT DHE VLERËSIMIT TË DEKLARATAVE

### Premtime jo i mbajtur

#### Infrastrukturë

#### Rregullimi i rrugës Prishtinë- Gjilan

Albin Kurti

Në kuadër të përmbajtjes së monitoruar gjatë muajit dhjetor, hibrid.info ka kontrolluar dhe analizuar një premtim.

Kryeministri Albin Kurti ishte shprehur se autostrada Prishtinë – Gjilan do të përfundonte dhe do të inaugurohej brenda vitit 2023. Pas verifikimit nga hibrid.info, është vërtetuar se nuk ka njoftim zyrtar se hapja e kësaj autostrade ka ndodhur në vitin 2023.

# Metodologjia

---

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në baza të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjithë artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben si një ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore, dhe atë në formë kryesisht kuantitative, për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese një mujore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër çrregullimit informativ. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar - IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 janar 2024, në të cilën janë trajtuar 65 përmbajtje keqinformuese.

---

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes një mujore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit janar 2024, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – [hibrid.info](http://hibrid.info)

Në bazë të përmbajtjeve keqinformuese të gjetura dhe të trajtuara gjatë muajit janar 2024, artikujt e vlerësuar si dezinformatë (26%) janë ato që kanë dominuar, duke u pasuar nga artikujt “clickbait” (22%) dhe lajmet i rreme (12%). Shkaku që dezinformata kanë dominuar gjatë këtij muaji është se shumë përmbajtje keqinformuese ndërlidhur me një mori temash sociale, janë vlerësuar si dezinformatë. Ndërsa artikujt “clickbait” janë nga fusha e kronikës së zezë ndërlidhur me raste tragjike (vdekje, vrasje) dhe ajo sociale, ku dominon tema e largimit masiv të popullsisë, të publikuara kryesisht në media informative në gjuhën shqipe dhe serbe. Lajmet e rreme janë kryesisht nga fusha e sigurisë lidhur me stërvitje ushtarake në kufirin Kosovë–Serbi, dhe ajo sociale për punë në Zvicër dhe tema të tjera sociale.

Rastet e ndryshme tragjike duke përfshirë vdekje, vrasje, aksidente, janë tematikat të cilat kanë mbizotëruar gjatë muajit janar 2024. Artikujt në kuadër të rasteve tragjike të keqinformimit kanë trajtuar vdekje, vrasje, aksidente dhe fatkeqësi në rrethana të ndryshme apo edhe tema të ndryshme sociale, për të cilat nuk bëhet e ditur në titujt e tyre vendi i ngjarjes apo titujt janë çorientues me synim për të nxitur klikime nga lexuesit, e të cilat kryesisht janë vlerësuar si “clickbait” dhe janë publikuar në portale informative. Në kuadër të muajit janar 2024, janë publikuar disa teori konspirative nga mediat në gjuhën serbe duke iu referuar Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë për incidente në vendbanimet serbe, ku interpretohen pa fakte se po bëhen në koordinimin me Prishtinën zyrtare me qëllim dëbimin e serbëve nga Kosova. Largimi masiv i popullsisë është tema e tretë që më së shumti u përdor për keqinformim nga mediat në gjuhën serbe dhe shqipe. Në mediat në gjuhën serbe u dezinformua me pretendimet se ka filluar tashmë eksodi i popullatës nga Kosova, ndërsa në media reale dhe media sociale në gjuhën shqipe u publikuan artikuj “clickbait” për udhëtimet nga aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës.

Gati gjysma e përmbajtjeve keqinformuese të gjetura dhe trajtuara gjatë janarit 2024 janë nga fusha e sociale (43%). Dy temat kryesore që kanë mbizotëruar, incidentet në vendbanimet serbe dhe largimi masiv i popullsisë, duke ia shtuar edhe punësimin në Zvicër, janë nga fusha sociale. Shumica e keqinformatave të publikuara nga kjo fushë u

vlerësuar si dezinformatë (11%), “clickbait” (9%) dhe teori konspirative (8%) dhe u publikuan në media sociale (25%), media reale (14%) dhe portale të dyshimta (5%). Fusha sociale pasohet nga ajo e sigurisë (22%), sa i përket përmbajtjeve keqinformuese të publikuara, të cilat janë vlerësuar në shumicë dezinformatë (6%) dhe lajm i rremë (6%). Këto përmbajtje keqinformuese kryesisht u publikuan në media sociale ndërlidhur me manovra ushtarake në kufirin Kosovë-Serbi, armatosjen e FSK-së, për luftë në Kosovë etj. Ndërsa, përmbajtjet keqinformuese nga kronika e zezë kryesisht janë publikuar në media reale, e që shumica prej tyre u vlerësuan “clickbait”. Temat kryesore janë raste të ndryshme tragjike për të cilat nuk qartësohet në titull vendi i ngjarjes duke lënë hapësirë për keqinformim.

---

Ministri i mbrojtjes, Ejup Maqedoni është figura që është përfolur më së shumti në disa nga përmbajtjet keqinformuese të trajtuara. Maqedonci u përfshi në pretendimet për investime në sisteme të armatimit, si dhe në deklaratën se FSK do të pajiset me anti-tank “Panzerfaust” duke pretenduar pa fakte se është thënë nga ai. Sa i përket institucioneve, Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë është përfshi në raportimet mediale në gjuhën serbe ndërlidhur me incidentet në vendbanimet serbe në Kosovë, për të cilat pretendohet pa fakte se janë në koordinim me Prishtinën zyrtare me qëllim të dëbimit të serbëve nga Kosova. Si institucion tjetër i përfolur është FSK-ja, me pretendime për armatosje me pajisje të ndryshme ushtarake dhe rreth pagave të pjesëtarëve të FSK-së.

---

Sa i përket kontrollit të deklaratave dhe premtimeve, Kryeministri Albin Kurti ishte shprehur se autostrada Prishtinë – Gjiilan do të përfundonte dhe do të inaugurohej brenda vitit 2023. Pas verifikimit nga hibrid.info, është vërtetuar se nuk ka njoftim zyrtar se hapja e kësaj autostrade ka ndodhur në vitin 2023.



HIBRIDO.INFO